



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**BLERJE KIMIKATE**”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kimikate për trajtimin e ujit 24962000-5**

Fondi limit: 34.216.666,67 (Tridhjetë e katër milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise është 358.439,83 (treqind e pesedhjetë e te mije e katerqind e tridhjetë e nente presje tetedhjetë e tre) Euro

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 13.05.2026 është 95.46 Lekë/Euro.*

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

1.Kryerja e furnizimit të kërkuar nga AK nga operatorë të ndryshem ekonomikë nuk do të ishte i favorshem, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të kryerjes së furnizimit, për kryerjen e procedurave të minikonkurimit nga AK, palë e kësaj MK.

2.Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të kryerjes së furnizimit. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për kryerjen e furnizimit në kohë, sigurimin e mallrave në kohën e kerkuar nga AK.

Marreveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshem për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në realizimin e furnizimit, duke bllokuar funksionimin normal i procesit të punës së SHRUKD sh.a.

Me qëllim garantimin e kryerjes së furnizimit në afatet kohore të përcaktuara për AK përfitues MK me një OE të vetëm do të garantonte sigurinë e kryerjes së furnizimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Bazuar në nenin 39 të LPP-së dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor vendos te mos e ndaje procedurën e prokurimit në lote për arsye sepse kjo garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e furnizimit me mallra.

Me qëllim garantimin e furnizimit brenda afatit kohor të përcaktuara, procedura jo e ndare në lote do të garantonte sigurinë e furnizimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afatit të kërkuar duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratës dhe të nevojave të AK.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4

b. Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: :

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% i fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023,2024,2025, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e përmbushur

nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, AK gjykon se kriteri i vendosur lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kërkesave pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a). për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b). për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke opatur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet koitl aktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë punojës të

specializuar/kualifikuar, si më poshtë ;

a) 2 drejtues mjetei ADR

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri,për punonjësit “Drejtues mjetei” OE duhet të paraqesin;

- Leje Drejtimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR)
- Kontratë pune të vlefshme
- Certifikatë trajnimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme(ADR).

Shënim; Në rast se mjetet janë me qera OE duhet të paraqesë kontratat e punës për punonjësit “Drejtues Mjetei” me subjektin që ka lidhur kontratën e qerasë së mjeteve.

b) 1 Kimist

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri,për punonjësin Kimist ,OE duhet të paraqesin;

- Diplomë
- Kontratë pune të vlefshme deri në zbatimin e plotë të kontratës (në rast se shpallen fitues)
- Librezë pune

Shënim;- Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas nenit 82 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 26 të VKM 285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vënd të parë, pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqesi Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me objektin e prokurimit për mallërat e kërkuar (hipokloritin e natriumit dhe Hipoklorit kalciumi). Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, Website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofruesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtperdrejte me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerinë e OE ofrues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben AK për njohjen e mundësisë së OE- së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, te ligjit 162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin

publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të V.K.M Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.2 Operatori ekonomik ofruar që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës, certifikatat kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. si më poshtë:

1. ISO 9001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të cilësisë
2. ISO 14001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të mjedisit,

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor** dhe nënvepër 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatën e prodhuesit** që vërteton konformitetin e produktit në prokurim me normat Europiane (EN 901: 2013) ose 901:2025) dhe 900:2014. Produkte kimike për tregëtimin e produkteve për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor,

Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë siguri të AK që OE ofruar do të paraqesë mallra, të cilat përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79, të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2021 “Për prokurimin publik”.

-EN 901:2013 është një standard evropian që lidhet me produktet kimike të përdorura për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konkretisht për hipokloritin e natriumit (Sodium hypochlorite), i cili përdoret gjerësisht për dezinfektimin e ujit.

Kërkimi i certifikatës që vërteton përputhshmërinë me EN 901:2013 është kërkuar sepse siguron origjinën dhe cilësinë e produktit dhe garanton që operatori ekonomik furnizon produkte të kontrolluara dhe të certifikuara. Produktet që përmbushin këtë standard kanë efektivitet të provuar në eliminimin e mikroorganizmave patogjenë në ujë, duke siguruar cilësi të qëndrueshme të trajtimit.

EN 900:2014 është një standard evropian që lidhet me gëlqeren (calcium oxide / calcium hydroxide) të përdorur në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Ky standard është thelbësor për procese si rregullimi i pH-së, zbutja e ujit dhe koagulimi.

Kërkesa që operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e prodhuesit për përputhshmëri me

EN 900:2014 është kërkuar sepse garanton origjinën dhe cilësinë e produktit dhe siguron përgjegjësi të qartë nga prodhuesi.

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

*a - një certifikatë **Nr.Reach** të prodhuesiti cili vërteton se prodhuesi/t është/janë të regjistruar dhe të certifikuar për tregtimin e hipokloritit të natriumit dhe hipokloritit të kalciumit për trajtimin e ujit për konsum njerëzor në komunitetin Europian.*

*b- **MSDS** (Skedes se Sigurie) per produktet objekt prokurmi.*

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofruet të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimet teknike dhe janë në përputhje me to. Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 8, te nenit 40, te VMM Nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Qëllimi i Reach është përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit përmes identifikimit të mirë dhe të hershëm të vetive të brëndëshme të substancave kimike. Rregullorja REACH i jep përgjegjësi më të madhe industrisë për të menaxhuar rreziqet nga kimikatet dhe për të siguruar informacion të sigurisë

Çdo prodhues ose importues i **hipokloritit të natriumit** dhe **hipokloritit të kalciumit** duhet të jetë i regjistruar për të lejuar tregtimin në tregun europian.

Regjistrimi REACH garanton që substancat janë vlerësuar për rreziqet ndaj shëndetit dhe mjedisit, duke minimizuar ndikimet negative në ujin e destinuar për konsum njerëzor.

MSDS përmban të dhëna mbi: përbërjen kimike, rreziqet (toksiciteti, korroziviteti), masat e mbrojtjes gjatë përdorimit, dhe procedurat në rast aksidenti.

MSDS siguron që operatorët që përdorin produktet (në impiantet e trajtimit të ujit) të kenë informacion të saktë për trajtimin, magazinimin dhe emergjencat.

Kërkesat për certifikatë **REACH** dhe **MSDS (Skedë Sigurie)** janë **proporcionale, të nevojshme dhe në përputhje me legjislacionin europian**, pasi garantojnë që kimikatet për trajtimin e ujit të pijshëm janë të sigurta, të kontrolluara dhe të përdorshme pa rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin.

Shënim. Nëqoftëse subjekti është prodhues vendas atëhere ai duhet të zhatojë ligjin nr 9180, datë 17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike “të regjistruar nga REACH dhe CLP.

2.4.5 Operatori ekonomik, në rastin kur shfaqet në cilësinë e importuesit të produkteve të mallit objekt-prokurimi duhet të paraqesë Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Licencave pra Ministrisë së Shëndetësisë për hipokloritin e natriumit, operatorët që nuk perfshihen në

kategorinë e mësipërme duhet të paraqesin një deklaratë të importuesit të klorit i cili deklaron se ka leje importi, në rast se importohet jashtë Republikës së Shqipërisë.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofrues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe në përputhje me to. Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 5, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, analizë kimike/fizike dhe toksikologjike për produktet që prokurohen, hipokloritin e natriumit dhe Hipoklorit kalciumit. Analizat e elementëve të cilat nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit publik nuk përbëjnë kusht për skualifikim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin deshmi të testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit.

2.4.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Duhet të ketë në pronësi ose me qera

- a) **2 (dy)** mjete të autorizuar tip autobot **ose** kamion , për transport kimikatesh (hipokloritin e natriumit dhe Hipoklorit kalciumit) , ku te paktën 1 (një) të jetë me kapacitet mbajtës 12-14 ton dhe 1 (një) me kapacitet mbajtës 15-25 ton, që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.

-Gjithashtu për transportin e hipokloritit të natriumit mund të përdoren depozita 1000 l IBC dhe në përputhje me dispozitat ADR sipas Ligjit 118/2012 “Per transportin e mallrave të rrezikshme” Kamionat që transportojnë kimikatet me këto depozita, duhet të jenë të paisur me certifikatë ADR për transport lëndësh të rrezikshme.

Për të vertetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet:

- a) dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit
- b) leje qarkullimi për “Transport lëndë të rrezikshme”,
- c) lejen e qarkullimit,
- d) certifikatën e kontrollit teknik,
- e) siguracionin e mjetit (të vlefshme),

- f) certificate konformiteti e cisternës rrugore dhe certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.
- g) Certifikatë për transport mallërash për të tretë dhe me qera brënda vëndit
- h) foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe target e mjetit.

Gjithashtu dhe për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet:

- a) Kontrata e qerave ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij
- c) lejen e qarkullimit,
- d) certifikatën e kontrollit teknik,
- e) siguracionin e mjetit (të vlefshme),
- f) certificate konformiteti e cisternës rrugore dhe certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.
- g) Certifikatë për transport mallërash për të tretë dhe me qera brënda vëndit
- h) foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe target e mjetit.

Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- a) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publik duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në cdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet dhe paisjet teknike të deklaruar.

Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjermën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

2.4.8 Operatori ekonomik duhet të deklaroje:

A. QË MERR PËRSIPER TË BËJË TRANSPORTIN E KLORIT HIPOKLORIT NATRIUMIT, ME MJETET E DEKLARUARA, NË TË GJITHA PIKAT AKTUALE PËRKATËSISHT:

1. **Stacioni i klorinimit Fushe Kuqe**
2. **Stacioni i klorinimit Fushe Kruje**
3. **Pusi FM4 Fushe Milot**
4. **Depo e shperndarjes (BPT), Bize**

5. *Stacioni klorinimit Cerme*
6. *Depo e shpendarjes qytetit Kavaje*
7. *Stacioni Kruje*
8. *Depo Maskuri*
9. *Stacioni Xhafzotaj*

B. QË MERR PËRSIPER TË BËJË TRANSPORTIN E KLORIT HIPOKLORIT KALCIUMIT, ME MJETET E DEKLARUARA, NË TË GJITHA PIKAT AKTUALE PËRKATËSISHT:

1.Njesia Operative Kavaje

2.Njesia Operative Rrogozhine

Sipas kërkesave te Autoritetit Kontraktor, si dhe në pika të tjera të mbulimit nga Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha në rast se do të shtohen gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Hipoklorit natriumi i lengshem (NaOCL)

Bazuar ne planin operacional dhe financiar per vitin 2026 sasia e parashikuar është 650 ton / 650.000 kg për 1 vit.

Nr	Pershkrimi	Njesia e matjes	Specifikimet
1	Gjendja	-	Leng I paster
2	Ngjyra	-	E verdhe
3	Densiteti 20°C	gr / ml	1.13 -1.28
4	Chloride (CL ₂)	% (m/m)	13 - 15
	<i>Substancattoksike</i>	mg/kg	<i>Limiett ne mg/kg tekloritaktiv</i>

5	Arsenik (As)	mg / kg	max 1,0
6	Cadmium (Cd)	mg / kg	max 2.5
7	Krom (Cr)	mg / kg	max 2.5
8	Merkur (Hg)	mg / kg	max 3.5
9	Nikel (Ni)	mg / kg	max 2.5
10	Plumb (Pb)	mg / kg	max 15
11	Antimon (Sb)	mg / kg	max 20
12	Selen (Se)	mg / kg	max 20

Malli duhet të dorëzohet pranë magazinave të klorit, të **SHRUKD sh.a,** në stacionet e klorinimit.

Afatet e lëvrimit: : Afati i lëvrimit do të jetë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor brenda 12 muajve nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të marreveshjes kuader.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike te Hipokloritit te Kalciumit Ca(ClO)₂

ne mg/Kg te klorit aktiv 60-70%

Nr.	Parametrat	Njesia Matjes	Specifikimet Kimike
1	Gjendja	-	Granular
2	Ngjyra	-	bardhe e hapur
3	Klor aktiv (Titulli I CL2)	% m/m	60-70
4	Kadmium (Cd)	mg/Kg	max 5
5	Krom (Cr)	mg/Kg	max 15
6	Nikel (Ni)	mg/Kg	max 8
7	Plumb (Pb)	mg/Kg	max 15

Hipokloriti I kalciumit duhet të jetë në përputhje me parametrat e Komunitetit European. Jetëgjatësia jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Automjetet duhet të jenë të certifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standarteve të BE për produktë që trajtojnë ujin e pijshëm.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

40 ton ose 40 000 kg Hipokloritit të Kalciumit Ca(ClO)₂

**Specifikimet teknike të Hipokloritit të Kalciumit Ca(ClO)₂
në mg/Kg të klorit aktiv 60-70%**

Nr.	Parametrat	Njesia Matjes	Specifikimet Kimike
-----	------------	---------------	---------------------

1	Gjendja	-	Granular
2	Ngjyra	-	bardhe e hapur
3	Klor aktiv (Titulli I CL2)	% m/m	60-70
4	Kadmium (Cd)	mg/Kg	max 5
5	Krom (Cr)	mg/Kg	max 15
6	Nikel (Ni)	mg/Kg	max 8
7	Plumb (Pb)	mg/Kg	max 15

Hipokloriti I kalciumit duhet të jetë në përputhje me parametrat e Komunitetit European. Jetëgjatësia jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Automjetet duhet të jenë të certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standarteve të BE për produktë që trajtojnë ujin e pijshëm.

Afatet e lëvrimit: : Afati i lëvrimit do të jetë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor brenda 12 muajve nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të marreveshjes kuader.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës do të jetë :

1. Zona Kavajë
2. Zona Rrogozhinë

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit janë të hartuara nga Grupi i Punës, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referenece emri i ndonje marke apo emri të veçante, patente, vizatim ose tip ose origjine ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.